



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Korçë, më datë 17/11/2022

Proces-verbal

Proces-verbal i mbajtur sot më datë 14 nëntor, ora 11:30 në kuadër të takimeve që Bashkia Korçë organizon me grupet e interesit për diskutimet për Paketën Fiskale të vitit 2023.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin Kletion Kita Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Soniel Prifti Drejtori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, Albert Nasto Kryetar i Shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm të Shqipërisë, si edhe Bujar Muço Zv. Kryetar i Shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm të Shqipërisë.

Gjatë këtij takimi u vu në dukje:

- Bashkëpunimi i ndërsjellë që Shoqata e Biznesit të Vogël dhe të Mesëm të Shqipërisë ka pasur me Bashkinë Korçë, kryesisht me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.
- Arritjet për formalizimin e biznesit në Bashkinë Korçë.
- Lufta kundër informalitetit.
- Ofrimi i shërbimeve në kohë dhe me cilësi për t'iu shërbyer sa më mirë banorëve të Bashkisë Korçë.
- Lehtësi fiskale lidhur me tarifat për subjektet që shërbejnë me tavolina jashtë lokalit për periudhën dhjetor, janar, shkurt.

Subjektet e bizneseve të cilat do të vazhdojnë të kenë numër të punësuarish mbi 20-50 punonjës, do të paguajnë 20% më pak të detyrimit të tarifave lokale, ata me mbi 50-100 të punësuar do të kenë përgjysmim të tarifave dhe me mbi 100 të punësuar do të vazhdojnë edhe përgjatë këtij viti të mos paguajnë tarifa lokale. Në fokusin e Bashkisë do të vijojnë të jenë bizneset e reja. Lehtësi do t'u jepet edhe bizneseve të artizanatit si edhe studentëve që do të hapin një biznes të ri.

Pas diskutimit të Paketës Fiskale në pjesën e Taksave dhe Tarifave që preket biznesi i vogël dhe i mesëm si edhe mbas diskutimit të ekzekutivit, Bashkia Korçë garantoj shoqatat që nuk do të ketë ndryshim të theksuar në taksat dhe tarifat për biznesin e vogël, të mesëm dhe të madh.

Përfaqësuesit e Shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm të Shqipërisë listuan kërkesat e tyre si në vijim:

- Shpërndarja me këste e detyrimeve të tarifave vendore për subjektet e biznesit.
- Minimizimi i kontrolleve nga inspektorët e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, policia bashkiake si edhe minimizimi i masave administrative të marra nga institucioni i bashkisë.

Proces-verbal i mbajtur sot më datë 14 nëntor, ora 12:00 në kuadër të takimeve që Bashkia Korçë organizon me grupet e interesit për diskutimet për Paketën Fiskale të vitit 2023.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin Kletion Kita Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Soniel Prifti Drejtori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, përfaqësuesit e biznesit të madh dhe ekspertët kontabël.

Gjatë këtij takimi u diskutua:

- Për lehtësitë fiskale që do të merrte Bashkia Korçë në numrin e të punësuarve. Biznesi i madh është më i prekur nga këto lehtësi.
- U garantuan subjektet se nuk do të ketë ndryshim të nivelit të taksave dhe tarifave vendore.

Përfaqësuesit e biznesit të madh dhe ekspertët kontabël listuan kërkesat e tyre si në vijim:

Biznesi dhe subjektet fashone i drejtuan një kërkesë Bashkisë Korçë për të ndërhyrë në çmimin që këto subjekte duhet të paguajnë për tërheqjen e mbetjeve teknologjike dhe industriale. Kjo pagesë nuk përfshihet në tarifën që paguajnë në Bashkinë Korçë por duhet të lidhin një kontratë me subjektet e licensuara për asgjësimin e tyre në Landfill.

Bashkia Korçë angazhohet të ndërmeretësojë arritjen e kësaj marrëveshjeje.

Proces-verbal i mbajtur sot më datë 14 nëntor, ora 13:00 në kuadër të takimeve që Bashkia Korçë organizon me grupet e interesit për diskutimet për Paketën Fiskale të vitit 2023.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin Kletion Kita Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Soniel Prifti Drejtori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, anëtarë të bordeve të zonave të biznesit BID dhe TID.

Gjatë këtij takimi anëtarët e bordeve të zonave të biznesit BID dhe TID falenderuan Bashkinë Korçë për nismën e ndërmarrë lidhur me përjashtimin nga tarifën e detyrueshme për zënien e hapësirave publike nga bizneset përgjatë muajve dhjetor, janar, shkurt.

Anëtarët e bordeve të zonave të biznesit BID dhe TID listuan kërkesat e tyre si në vijim:

- Pastrim më të shpeshtë të territorit.
- Të tregohet më shumë kujdes me qentë e rrugëve pasi përbëjnë rrezik për këmbësorët, veçanërisht në këto dy zona.

Konceptoi
Lorena Saro

Drejtoresha e Marrëdhënieve me Publikun dhe
Informimit Qytetar
Larisa Katundi

Perfaqësues të shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm të Shqipërisë



Përfaqësues të biznesit të madh dhe ekspertë kontabël





Anëtarë të bordeve drejtuese të zonave të biznesit BID dhe TID

